

VENDIM
Nr. 605, datë 29.7.2020

PËR REGJISTRIMIN E PEMËVE DHE TË PASURIVE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme të pemëve (drurë ose grupe drurësh) dhe të pasurive natyrore, si më poshtë vijon:

- a) lumë, sipas kuptimit të pikës 27, të nenit 4, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- b) liqen, sipas kuptimit të pikës 26, të nenit 4, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- c) mal;
- ç) basen, sipas kuptimit të pikës 7, të nenit 4, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar;
- d) minierë, sipas kuptimit të pikës 5, të nenit 2, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- dh) pus nafte, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar;
- e) çdo pasuri tjetër natyrore, në përputhje me përcaktimet e nenit 142 të Kodit Civil.

2. Regjistrimi i pasurive natyrore, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet kryesisht nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “ASHK”) gjatë procedurës së regjistrimit fillestar dhe përmirësimit/përditësimit apo me aplikim të pronarit/përfaqësuesit të autorizuar.

3. Për pasuritë e llojit pemë regjistrimi, në çdo rast, bëhet vetëm me kërkesë të pronarit (shtet apo privat) të pasurisë ku gjenden pemët.

II. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIMIN E PEMËVE

4. Në kategorinë e pemëve që regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme hyjnë të gjithë drurët që ndodhen brenda kufirit të pasurisë (tokës), pavarësisht llojit dhe pronësisë së pasurisë (nëse është private apo shtetërore).

5. Kërkesa për regjistrimin e pemëve nga subjekti i interesuar duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) listën e detajuar të inventarit të pemëve;
- b) planin e rlevimit (paraqitja grafike e pronës dhe pemëve), sipas modelit të miratuar;
- c) aktin e fitimit të pronësisë, nëse nuk është regjistruar më parë.

6. Për regjistrimin e pemëve në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, drejtoria vendore e ASHK-së verifikon këto elemente:

- a) legjitimitimin e subjektit, nëse ai është është pronari/bashkëpronari i pasurisë së paluajtshme mbi të cilën do të regjistrohen pemët apo përfaqësuesi i autorizuar i tij;
- b) nëse dokumentacioni i depozituar për regjistrimin e pemëve është i plotë, sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij vendimi.

7. Kur pas kryerjes së verifikimeve, kërkesa për regjistrimin e pemëve i përmbush kushtet e përcaktura në lidhje me dokumentacionin dhe legjitimitimin e subjektit, sipas pikës 6, të këtij vendimi, vijohet me regjistrimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme, sipas të dhënave të paraqitura në dokumentacionin tekniko-ligjor të depozituar për regjistrim, në përputhje me

përcaktimet e nenit 29, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

8. Për pemët, regjistrimi kryhet duke pasqyruar numrin total të tyre, në rubrikën përkatëse të kartelës së pasurisë së paluajtshme.

9. Ndryshimi i numrit të pemëve, sipas gjendjes faktike nga momenti i regjistrimit, bëhet sipas akteve të miratuara nga organet kompetente dhe reflektohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me kërkesën e pronarit apo personave të tjerë të autorizuar prej tij.

10. Pas regjistrimit të pemëve në regjistrat kadastralë, drejtoria vendore e ASHK-së pajis pronarin me kartelën e pasurisë, si dhe me sasinë e nevojshme të matrikujve për çdo pemë të regjistruar.

11. Matrikujt janë tabelat ku pasqyrohen numrat rendorë të pemëve dhe që vendosen nga pronari në çdo pemë. Pronari që ka kërkuar regjistrimin e pemëve është i detyruar të pasqyrojë numrat rendorë identifikues të pemës në secilën tabelë.

12. Modeli i matrikullit përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së. Matrikujt blihen nga ASHK-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i vendosen në dispozicion pronarit.

III. PASQYRIMI I PASURIVE NATYRORE NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME

13. Informacioni për pasuritë natyrore pasqyrohet në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në rubrikën “lloji i pasurisë”, në seksionin “A” të saj. Në rastin e maleve, për efekt regjistrimi, lloji i pasurisë “mal” shënohet vetëm në kartelat e atyre sipërfaqeve të shpateve ose të majave të maleve, që nuk janë trajtuar ose inventarizuar, me dokumentacion ligjor si lloje të tjera pasurie.

14. Kur pasuria natyrore shtrihet në më shumë se një zonë kadastrale ajo pasqyrohet në kartela pasurie më vete, sipas secilës zonë, për pjesën përkatëse të sipërfaqes së pasurisë natyrore.

15. Në rastet e parashikuara në pikën 14, të këtij vendimi, numërtimi i pasurisë do të kryhet sipas rregullit bazë të vendosjes së numrit të pasurisë në një zonë kadastrale, duke bërë shënimin në kartelën e pasurisë për lidhjen e pasurisë natyrore midis zonave kadastrale kufitare.

16. Pasqyrimi në hartën kadastrale i pasurive natyrore, si: lumenj, liqene, male, basene, miniera, puse naftë, si dhe çdo pasuri tjetër natyrore, në përputhje me përcaktimet e nenit 142, të Kodit Civil dhe të nenit 62, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, kryhet sipas shenjave konvencionale përkatëse, të cilat ndryshojnë në varësi të shkallës së paraqitjes së hartës. Shenjat konvencionale të pasurive natyrore miratohen me udhëzim të përbashkët të drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së dhe drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

17. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe